



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-AKP nr.01/2021

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nebojša Boričić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

A. K., me vendbanim në

Kundër:

Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, (tutje, AKKVP),

Duke vendosur lidhur me Ankesën e paraqitur, kundër Vendimit Përfundimtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës,(tutje; KKPK), nr., të datës 07 Maj 2020, dhe njoftimit për lirim e pronës së AKKVP, nr....., në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 30 mars 2021, merr:

AKTVENDIM

Hedhet si e palejueshme Ankesa e A.K., e paraqitur kundër Vendimit Përfundimtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës,(tutje; KKPK), nr., të datës 07 Maj 2020, dhe njoftimit për lirim e pronës së AKKVP, nr.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;

1. Nga shkresat e lëndës dhe theksimeve në ankesë rezulton se; Komisioni për Kërkesa Pronësore Banësore, (tutje KKPB), me Vendimin nr., të dt. 16 dhjetor 2005, ka vendosur, që kërkesa e kategorisë “A” e palës kërkuese, z. F. H., të aprovet dhe ti kthehet e drejta e pronësore, në banesën e cila gjendet në, ndërsa palës përgjegjëse në kërkesën e kategorisë “A”, të palës kërkuese si më lartë, O. M.c, sipas arsyeve të dhëna në pikën 12, 17 dhe 20, të njëjtit vendim, vendoset që ti njihet e drejta në kompensim, si në kuptim të nenit 4 të rreg. së UNMIK 2000/60.

2. Kundër vendimit të lartë cekur të të shkallës së parë, të KKP, nr. ..., të dt. 16 dhjetor 2005, kërkesë për rishqyrtim si palë e interesuar në shkallën e dytë ka ushtruar A.K., (tutje pala ankuese). Komisioni i shkallës së dytë me vendimin përfundimtar, ..., të dt. 19 janar 2007, e aprovon kërkesën e tij, ndërsa e ndryshon vendimin e më parshëm ashtu që kërkesa e kategorisë “A”, ..., e palës kërkuese F. H. aprovohet dhe e drejta pronësore i kthehet pasi të paguan shumën e cila përcaktohet nga Drejtoria për Çështje Banesore Pronësore, dhe pas pagesës së shumës komisioni lëshon urdhër përfundimtar duke ia dhënë pronësin sipas nenit 4.2 të rreg. së UNMIK 2000/60. Ndërsa pronarit të parë V., nëse sjellë dëshmi se e ka kthyer qmimin blerës të cilin e ka pranuar nga pala kërkuese (tani ankuese A.K.), sipas marrveshjes së pavlefshme mbi shitjen të lidhur në mes tyre, pas hyrjes në fuqi të rreg. së UNMIK 2000/60). Pala ankuese sipas këtij vendimi-urdhëri të ndryshuar sipas kërkesës së tij, do të ketë të drejtën të kompensohet nga Drejtoria, (arsyet e specifikuar lidhur me mënyrën e vendosjes të kërkesës ... si në pikat 32-37, dhe pikat 41-44, të vendimit grupor), mbi kërkesën e rishqyrtuar-urdhërit, ... të dt. 19.01.2007).
3. Sipas Ligjit 05/L-010, AKKVP, për veq mandatit kryesor të saj, ka trashëguar një pjesë të përgjegjësi dhe të mandatit të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe të ish Drejtorisë për Çështje Banesore dhe Pronësore, (kësaj të fundit kryesisht lidhur me implementimin e vendimeve të saj të plotëfuqishme), ashtu si parashihet në nenet 17-19, të këtij ligji.
4. AKKVP, bazuar në dispozitat ligjore të ligjit nr. 05/L-010, të cekura si më lartë, në këtë çështje pas përfundimit të procedurave përgatitore rreth kritereve dhe procedurave të përlllogaritjes së shumave dhe pagesave, nga komisioni vlerësues, me kërkesën e F. H. i cili kishte kërkuar kthimin e të drejtës pronësore, agjencia duke vepruar edhe sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ, nr. 10/2018, ka filluar zbatimin e vendimit të plotëfuqishëm të Komisionit për Kërkesa Banesore Pronësore, ..., të datës 19 janar 2007, me të cilin vendim atij i ishte kthyer e drejta pronësore.
5. Me vendimin përfundimtar ..., të dt. 07 maj 2020, dhe vendimin individual të vërtetuar, të dt. 17.06.2020, sipas kërkesës së tij nr., në zbatim të vendimit të plotëfuqishëm dhe bazuar në të me nr., të datës 19 janar 2007, me të cilin z. F. H., i aprovohet pronësia mbi pronën lëndore..., tani me vendimin përfundimtar i kofirmohet kjo e drjetë dhe urdhërohet të regjistrohet si pronar ligjor i banesës lëndore në shënimet publike përkatëse, nga dita e pranimit

të vendimit-urdhërit. Ndërsa çdo person, apo palë përgjegjëse, që pa të drejtë e ka uzurpuar apo gjendet në banesë duhet ta liroj në afat prej 30 ditë.

6. Pala ankuese A.K., kundër vendimit përfundimtar,, të dt. 07.05.2020, dhe njoftimit për lirim e pronës, banesës lëndore ushtron ankesë në Gjyaktë Supreme me të cilën e konteston ligjshërinë e të njëjtit nga shkaqet; se vendimi përmban gabim të rëndë dhe moszbatim serioz të së drejtës lëndore dhe procedural, dhe Vendimi bazohet në fakte jo të plota apo në vlerësim të gabuar të fakteve, tutje e përhkruan gjendjen faktike duke theksuar ndër të tjera se me dt. 19.05.1997, ish pronarit të banesës V. J. M. i ishte ndarë dhe e kishte në posedim të ligjshëm banesën lëndore të cilën nga ai e ka blerë me datë 26.10.2001, me kontratë të shitblerjes të vërtetuar në Gjykatë (nr. vërtet. 1480/2001), edhe në Komunë Prishtinë nr. 03-1/1240 dt. 31.10.2001, dhe prej vitit 2012 banesa në kadastër evidentohet në emër të tij. Tutje thekson se KÇBP ka nxjerrë vendim të kundërligjshëm me nr., ndaj të cilit ka shtruar kërkesë për rishqyrtim dhe pas kësaj periudhe nuk ka marrë përgjigje gjer sa me 19.10.2020, ka pranuar vendimin të cilin e atakon nga shkaqet e cekura si më lartë etj. Në fund propozon që ankesa të aprovet në tërësi si e bazuar, të anulohet vendimi i ankimuar, nr., të dt. 07.05.2020, dhe Vendimi I KÇBP, nr., të dt. 16 dhjetor 2005, ndërsa AKKVP, të obligohet që tia kompensoj të gjitha shpenzimet gjyqësore.

Arsyetimi ligjor;

-Juridiksioni,

7. Gjykata Supreme, kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndëve sipas ankesës të ish Agjencisë Kosovare të Pronave, tani Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të tjera, të paraqitura nga pala ankuese gjen se, kjo gjykatë nuk ka kompetencë ligjore për të vendosur, lidhur me Vendimet e ankimuara atë të KKP, nr., të dt. 16 dhjetor 2005, dhe Vendimit përfundimtar, të datës, 07 Maj 2020 Gjer sa kjo qështje banesore lidhur me kërkesën lëndore, është vendosur edhe me vendimin përfundimtar,, të datës 19 janar 2007.
8. Sipas Ligjit në fuqi nr.05/-L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të pronës, nuk është e paraparë që vendimet e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB), apo aktet e tjera të lidhura me këto vendime, si në rastin konkret vendimi përfundimtar

....., të dates 07 Maj 2020, se mund të jenë objekt i kontestimit qoft me padi apo me ankesë në Gjykatë Supeme, gjer sa sipas neneve 17-19, të këtij ligji AKKVP, ka kompetenca të ekzekutoj vendimet e plotëfuqishme të Komisionit për Kërkesa Pronësore, aktgjykimet e Gjykatës Supreme dhe Vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, dhe të bëjë lëshimin dhe ekzekutimin e urdhërit për dëbim të qdo personi që është duke qëndruar në mënyrë të pa ligjshme në një pronë, të vendosur me vendim të plotëfuqishëm të KKPB.

9. Nga faktet e cekura më lartë rezulton se kjo çështje banesore është vendosur me Vendimin e shkallës së parë të ankimuar, të dt. 16 dhjetor 2005, si dhe vendimin përfundimtar të shkallës së dytë të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, nr., të datës 19 janar 2007, ashtu si u cek në pikën 2, të këtij aktvendimi.
10. Sipas nenit 2.7, të Rregullores së UNMIK, nr.1999/23, të datës 15 Nëntor 1999, Vendimet e Komisionit për Kërkesa pronësore Banesore, janë të detyrueshme për tu zbatuar **dhe nuk janë objekt i ri i shqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.**
11. Vendimi, i datës 19 janar 2007, është i plotëfuqishëm, në pajtim me nenin 2, paragraf 7, të Rregullores së lartë cekur, nr. 1999/23, i njëjti nuk mund të ankimohet, në këtë fazë, as sipas Rregullores së UNMIK nr.2000/60, sepse dispozitat e këtyre dy rregulloreve të cekura si më lartë, si dhe aktet ligjore të më vonshme dhe tani në fuqi që e rregullojnë këtë lëmi, nuk parashofin ndonjë mjet juridik të rregullt, apo të jashtëzakonshëm të goditjes ndaj vendimeve përfundimtare të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.
12. Sipas dispozitave të Rregullores së lartë cekur, nr. 1999/23, pas vendosjes nga Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore me vendim i cili është bërë i formës së prerë, çështja e vendosur trajtohet, *res judicata*, **sepse sipas nenit 2.5, të kësaj Rregullore, në çështjet e pronave banesore, jurisdiksioni i gjykatave lokale ishte përjashtues, ndërsa komisioni ka kompetenca ekskluzive për të zgjidhë kategoritë e kërkesave të theksuara si në nenin 1.2, të kësaj rregullore.**
13. Ngjajshëm është edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, sa u përket vendimeve të formës së prerë të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, (shih

Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin **me numër, KI 104/10**, e në mënyrë specifike paragrafët, 64-75, të këtij aktgjykimi).

14. Nga të lartë cekurat e në kuptim të nenit 13, par. 1 dhe 2, dhe neni 13. 3 c), të Rregullores së UNMIK, nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin, nr. 03/L-079, dhe neni 16.3, parag.3.2, të Ligjit 05/L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Këshilla Juridike;

15. Sipas nenit 13.6, të Ligjit 03/L-079, ky aktvendim është i plotfuqishëm, i njëjti nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

AC-AKP nr. 01/2021, me datë 30 mars 2021

Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani